

Amfara

Botim i Albaqeramika | Edicioni numër 13 | Mars 2017



albaqeramika
....

INSPIRIM PRANVERE

Rrezet e para të diellit pas dimrit janë përkëdhelja e parë që na bën pranvera, për të paralajmëruar përfundimin e ditëve të ftohta. Ndonëse kjo na ndodh çdo vit pa përjashtim, megjithatë për çdo vit pranvera na duket si fillim i ri. Si një rilindje me energji e dëshira të reja. Pa dyshim që është kjo stina më ngazëlluese dhe më shpresëdhënëse e vinit. Është koha kur çdo gjë e shohim në drithë më pozitive dhe kur edhe natyra ngjyroset me lloj-lloj nuancash.

“Pranvera është koha e planeve dhe projekteve”, ka thënë shkrimtari Leon Tolstoj, e ne themi që pranvera është edhe kohë inspirimi.

Këto të dyja vetëm sa e plotësojnë njëra-tjetrën, sepse planet dhe projektet e reja gjithsesi kërkojnë inspirim.

Andaj ne, në Albaqeramika, këtë pranverë kemi lansuar webfaqen e re me moton “Inspirohu”.

Çdo ide, çdo nismë, edhe ato më të mëdhatë që kanë ndryshuar botën kanë nxënë rrënjenë në një çast inspirimi. Inspirimi, pra, do të duhej të jetë ushqim i ideve të reja.

Përmes webfaqes sonë të re, ne jemi munduar që të sjellim kësot çaste inspirimi për të gjithë ata që duan ta ndërtojnë një banjo të re, ta rinovojnë banjon e tyre, apo vetëm të ndërrojnë vaskën. Për ata që ndoshta dëshirojnë të vendosin një dushkabinë në një kënd të banjos së tyre, ose ata që duan të kenë pllakat më të mira në kuzhinë.

Kemi krijuar ambiente të tëra me produktet tona në cilësinë më të lartë të mundshme të disejnit dhe fotografisë, për ta sjellur sa më afér klientit ndjenjën e elegancën e produkteve më fine që mund të gjenden sot në tregun e qeramikave dhe sanitarisë.

Gjithmonë kemi dyshime e dilema kur duam të bëjmë një ndryshim në shtëpinë tonë, ose kur duhet të ndërtojmë ambiente të reja. Këto dyshime e dilema na shkaktojnë kokëçarje e nervozë të pafund. Por, nëse kemi një burim inspirimi - këto dyshime e dilema përherë marrin zgjidhje.

Andaj tash është e lehtë - Inspirohu në Albaqeramika.

Në Albaqeramika gjen më shumë se banjo

Për të pasur një banjo të kompletuar në çdo aspekt nevojiten më shumë sesa vetëm pllakat dhe sanitari cilësore. Albaqeramika ka menduar përsosmërinë e banjos deri në detajin më të vogël. Për të rehatuar klientët ne kemi të angazhuar hidroinixhiner me ekip të profesionalizuar për të projektuar banjot ose ambientet e tjera nga zeroja.

Faton Gashi, hidroinixhiner me përvojë të gjatë, e bën punën e tij me pasion në mënyrë që secili klient të ndahet i kënaqr.

Fatoni e bën punën me shumë përkushtim, ngase produktet e instalimeve në Albaqeramika janë të kompanive me renome botërore dhe të kualitetit më të lartë të llojit të tyre, duke filluar nga Geberit –brend zvicrran që është lider në sektorin e sistemit të ujësjellësit, kanalizimit dhe pajisjeve sanitare e gjithashtu materialet përcjellëse për ndërtim të kompanive si AlcaPlast, Ceresit dhe Isomat.

Por është Geberit diçka që ia bën punën edhe më të veçantë hidroinixhinerit në Albaqeramika.

“Të punosh me produktet e Geberit është ëndërr e çdo inxhinieri. Geberit pasqyron një seriozitet të madh dhe kualitet të lartë”, thotë ai.



Cad. Msc. Hidro
Faton Gashi

GEBERIT




Pa zhurmë

Kualitet i lartë

Rezistent ndaj temp. + / -

Produkt i garantuar



Në vitet e fundit jemi angazhuar shumë edhe me projekte të ndërtimeve të larta, në këtë mënyrë duke i vënë rëndësi të veçantë banjos, që banorët të mos kenë kurrë probleme me funksionalitetin e banjos. Ndër projektet më të veçanta ku kemi instaluar kompletni sistem Geberit janë kompleksi banesor KaWa, tri objektet e Vëllezërit Asllani, Cima dhe Art Construction.

Geberit është një sistem ideal që i plotëson të gjitha rregullat përkatëse, si ato të mbrojtjes nga zjarri, të izolimit të menduara mirë deri në detajin e fundit sa i përket teknologjisë së instalimit.

E konsiderojmë si përparësi të madhe të pasurit e hidroinixhinerit me eksperiencë në Albaqeramika, i cili bën projekte e instalimit të kanalizimit dhe ujësjellësit paralelisht me arkitektët në mënyrë që cilësia e objekteve të jetë shumë e lartë.

Në kuadër të punës sonë ne bëjmë edhe testimin e kompletnimit që bëhet me ujë nën presion të lartë për të parë se a është bërë lidhja mirë, për të vazhduar projektin me nivelizim, pllaka dhe sanitari. Gjithashtu, punët mbikëqyrën deri në pikën e fundit nga inxhinieri, sepse dëshirojmë që klienti të jetë i kënaqr me bashkëpunimin.

Vërtet, ndjehemi të kënaqr kur investitorët e ndërtimeve të larta e theksojnë në komunë se objekti do të përbajë instalimin e kanalizimit dhe ujësjellësit me Geberit, sepse kjo menjëherë e rangon projektin si shumë serioz.

GEBERIT 10 VJET GARANCION, 50 VJET JETËGJATËSI

Geberit Mepla

Sistem i ujësjellësit për fleksibilitet dhe performancë të lartë

Gypat e ujësjellësit Geberit Mepla, me përdorim universal, përbëhen nga gypat/tubat e sistemit me nofullat me presim dhe veglat e presimit. Gypat e ujësjellësit gjenden me diametër nga 16 deri në 75 mm.

Një shumëllojshmëri fitingjesh bashkuese për të gjitha kërkesat dhe zgjidhje intelegrante, shumë lehtë e përshtatshme për lidhjen e këtij sistemi në elementet të tjera jashtë këtij sistemi.

Shumë arsyе për përdorimin e sistemit Geberit Mepla:

- Qëndrueshmëria: Gyp tre shtresorë me masë plastike, rrjete alumini dhe polietileni
- Cilësi e garantuar në lidhje me fitinge
- Mundësia e lehtë për harkim




Geberit Silent PP


“Tingulli i qetësisë”

Tubat e kanalizimit Geberit Silent PP, sistem ky i cili ofron qasje të re në sistemet e gypave të kullimit. Geberit Silent PP montohen lehtë, kanë shumëllojshmëri të fitingjeve, shumëllojshmëri të elementeve të jashtme. Tubat janë tre shtresorë dhe kështu reduktojnë zhurmën e shkarkimit duke e bërë këtë sistem të përsosur.

Disa nga veçoritë që e dallojnë nga të tjerët:

- Rezistencë ndaj rrezatimit UV
- Izolim i sigurt dhe akustik
- Rezistencë ndaj goditjes në temperaturat të ulëta.





INSPIROHU NË ALBAQERAMIKA.COM

Sapo kemi lansuar uebfaqen e re me moton INSPIROHU. Qëllimi kryesor është që t'u ofrojmë klientëve mundësi inspirimi për renovimin, ndryshimin dhe dekorimin e hapësirave, disejnimin dhe ndërtimin e tyre.

Përveç kësaj, uebfaqja e re është pasuruar me produktet më të reja që kemi sjellur nga partnerët me renome nga Italia, Spanja e më gjjerë.

Për të festuar lansimin e uebfaqes së re ne organizuam edhe lojën shpërblyese INSPIROHU ME IPHONE 7, ku ftuam të gjithë ndjekësit e faqës së AlbaQeramika në Facebook të inspirohen në uebfaqen e re dhe të qëllojnë se prapa cilit produkt ne fshehëm një Iphone 7.

Përzgjedhja e pllakave "Adorn" nga Spanja, Edona Shalën e bëri fituese të Iphone 7. Ne kaluam një pasdite të këndshme në objektin e AlbaQeramikës në Prizren me fituesen e lojës shpërblyese, kur edhe ia dorëzuam telefonin.

Edhe një herë falënderojmë Edonën dhe të gjithë pjesëmarrësit e lojës, të cilët u inspiruan me uebfaqen e re të AlbaQeramikës.

www.albaqeramika.com

AlbaQeramika përkatë K.B. Bashkimi

Në vazhdën e përkrahjes së sportit në vend, edhe këtë sezoni AlbaQeramika vazhdoi me përkrahjen e sportit, aty ku më së shumë qejf u bëmë sponsor të ekipeve të basketbollit K.B. Bashkimi nga Prizreni, duke i dëshiruar suksese në këtë edicion garash.

